



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.06.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe votimi i aktit normativ nr. 9, datë 11.5.2022, “Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg””. (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Laert Duraj, Fadil Nasufi, Tatiana Piro, Luljeta Bozo, Ismet Beqiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Benet Beci, Rrahman Rraja, Xhelal Mziu, Agron Duka, Nusret Avdulla dhe Ilir Pendavinji.

Mungojnë:

Anduel Tahiraj, Flamur Hoxha, Fatjon Veizaj, Lefter Gështenja, Ramadan Likaj dhe Zef Hila.

Të ftuar:

Delina Ibrahimaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Kesjana Halili – Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi – Drejtore në Drejtorinë e Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit, Drejtorja e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Lorisa Kushi – Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Sigurimit të Ndhmës së Huaj dhe Marrëveshjeve, Drejtoria e Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndhmës së Huaj, Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Saimir Muçmataj – Drejtor në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Idlir Gjata - Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Mirëmëngjesi!

Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin kemi shqyrtimin e aktit normativ “Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg””.

Relator i këtij projektligji është zoti Fadil Nasufi, kurse ne jemi komision për dhënie mendimi.

Të ftuar nga Ministria e Financave për të prezantuar aktin normativ kemi ministren, zonjën Delina Ibrahimaj; zonjën Kesjana Halili, drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik; zotin Nikolla Lera, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale; zonjën Brikena Jazxhi, drejtore në Drejtorinë e Strategjisë dhe Monitorimit; zonjën Lorisa Kushi, përgjegjëse sektori; zotin Saimir Muçmataj, drejtor në Drejtorinë e Programimit dhe zotin Ildir Gjata, këshilltar në Ministrinë e Financave.

Mirë se keni ardhur!

Zonja Ministre, do ta merrni ju fjalën?

Delina Ibrahimaj – Përshëndetje të gjithëve!

Qëllimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 41/2022 “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”” është të mundësojë një element suportues për subjektet që u nënshtrohen masave me karakter detyrues të përcaktuara në këtë ligj, konkretisht detyrimit për mbajtjen e rezervave të produkteve për një periudhë tremujore.

Situata emergjente e krijuar nga rritja e menjëhershme e çmimeve të produkteve ushqimore bazë në tregun shqiptar, ardhur si pasojë e situatave të ndikuara nga tregu ndërkombëtar, e ka bërë të domosdoshme ndërhyrjen dhe rregullimin e kësaj situatë me anë të këtij akti normativ. Konkretisht, synohet mbështetja me një garanci shtetërore nga e cila mund të përfitojnë subjektet që tregtojnë produkte me shumicë, për të mundësuar financimin e nevojshëm për mbajtjen e rezervave.

Në kushtet kur masa për mbajtjen e një rezerve tremujore të produkteve do të kërkonte një likuiditet të konsiderueshëm, dhënia e një garancie shtetërore, e cila do të rriste aksesin në financim të këtyre subjekteve pranë sistemit tonë bankar, u vlerësua si një

mekanizëm i nevojshëm për implementimin sa më me efektivitet të kësaj mase të parashikuar. Ky ndryshim i propozuar në vetvete nuk ka efekt financiar në buxhetin e shtetit.

Garancia shtetërore që do të jepet do t'u nënshtrohet procedurave të miratimeve sipas legjislacionit në fuqi. Konkretisht, garancia shtetërore miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe më pas vijohet me lidhjen e marrëveshjeve të veçanta nga ministri i Financave dhe Ekonomisë me bankat e nivelit të dytë.

Kjo nismë u gjykua si e domosdoshme për mbështetjen e bizneseve për të garantuar ofrimin e produkteve ushqimore bazë në kushtet kur oferta në tregjet ndërkombëtare ka ardhur në ngadalësim. Për këtë arsye, unë mendoj se ishte nisma e duhur që qeveria shqiptare ndërmoi me qëllim tejkalimin e kësaj situatë.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka relatori, zoti Nasufi.

Fadil Nasufi - Faleminderit, kryetar!

Siç e tha edhe zonja ministre, sot kemi për diskutim aktin normativ nr. 9, datë 11.05.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg””.

Në pikën 2 të nenit 8 bëhet shtesa me këtë përmbajtje: “Për mbajtjen e rezervave, sipas kësaj pike, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg, Këshilli i Ministrave miraton garanci shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë, si dhe kushtet dhe kriteret e marrëveshjes tip të garancisë dhe marrëveshjes tip të mirëkuptimit”.

Pra, qëllimi është të mundësohet mbajtja e rezervave për një periudhë tremujore ose sa është jetëgjatësia e produktit nga subjektet që tregtojnë produkte ushqimore me shumicë, e dyta, Këshilli i Ministrave të jap autorizimin e miratimit të garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes nga subjektet që tregtojnë me shumicë dhe e treta, të miratohen kushtet dhe kriteret e marrëveshjes tip të garancisë dhe të marrëveshjes tip të mirëkuptimit.

Ky akt normativ nuk është planifikuar në projekt-aktet e Këshillit të Ministrave, por e dikton situata emergjente e rritjes së çmimeve në treg të produkteve ushqimore.

Krijimi i një rezerve tremujore kërkon likuiditete të konsiderueshme, por një pjesë e mirë e subjekteve që tregtojnë produkte ushqimore me shumicë nuk i kanë këto mundësi.

Ndaj, nëpërmjet këtij akti normativ u mundësohet kjo mundësi financimi dhe huamarrje nga bankat e nivelit të dytë.

Ka përputhje me nenin 156 të Kushtetutës, ku përcaktohet se shteti mund të garantojë hua kur autorizohet me ligj.

Dihet që procedurat e huamarrjes janë të përcaktuara në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, por procedurat e këtij ligji të huamarrjes vazhdojnë për një periudhë 6-mjore dhe situata për të cilën ne kërkojmë të ndërhyjmë për të krijuar rezervë tremujore nuk e favorizon këtë mundësi. Ndaj, kërkohet të bëhet ky rregullim i përkohshëm me këtë akt normativ, që e bën efektiv krijimin e rezervës dhe skemën e garancisë shtetërore. Pra, jemi në kushtet e emergjencës dhe akti normativ është i domosdoshëm që t'i paraprijë zgjidhjes së këtyre problemeve që kanë të bëjnë me këtë situatë që nuk ka sjellë efekt në rritjen e çmimeve vetëm në Shqipëri, por është një problem me përmasa ndërkombëtare.

Në kushtet e rregullimit të përkohshëm të situatës me akt normativ, qeveria është mbështetur në nenin 101 të Kushtetutës, që i jep të drejtën Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi - Faleminderit, zoti Nasufi!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Bushati.

Helidon Bushati – Ndryshimin e aktit normativ, që kaloi në datën 21, opozita e votoi kundër pasi ne besojmë se nuk ishte kjo rruga e duhur, por rruga e duhur ishte marrja e disa masave të tjera, si ulja e TVSH-së, ato që do të ndikonin në mbajtjen e çmimit në nivele të pranueshme, duke marrë parasysh edhe ndikimin e elementeve që nuk varen nga Shqipëria, që lidhen me konflikte e të tjera.

Një fakt që na jep të drejtë neve, zonja Ministre, është edhe shqetësimi që ngritën grosistët, për të cilët ne po diskutojmë sot, sepse për t'u ardhur në ndihmë grosistëve po bëhet ky ndryshim i aktit normativ sot.

Cili ishte shqetësimi që ata ngritën para disa ditësh në bordin e vendosjes së çmimeve? Shqetësimi ishte rritja e jashtëzakonshme e kontrabandës nga të tria vendet kufitare me Shqipërinë: Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia. Çdokush do të pyeste veten, zonja Ministre: pse subjektet tregtare me pakicë, ato të vogla, shkojnë blejnë në Maqedoni, ku TVSH-ja është zero, dhe në vendet e tjera të njëjtin produkt që ne e blejmë 30-40 më shtrenjtë? Ky është problemi, zonja Ministre.

E ritheksoj, ne e kemi votuar kundër aktin normativ, por pas votimit kundër, në vetvete ky akt u vjen në ndihmë bizneseve. Ky ndryshim duhet bërë për bizneset, sepse kërkohet një rezervë ushqimore tremujore dhe ky është një impakt financiar jo i vogël, sepse ato do të krijojnë stok, por nuk është bordi zgjidhja. Ky është problemi.

Blerjet kanë rënë me 55%, zonja Ministre, së paku të vajit, një prej produkteve që po kontrabandohet në Shqipëri, sepse blihet në tregjet kufitare me çmim shumë më të lirë dhe me gjithë rritjen e kostos së transportit përsëri këtu shitet me një çmim rreth 310-320 lekë. Ndërkohë, çmimi i vendosur nga bordi është 400 lekë, nëse nuk gaboj. Prandaj, duhet të shikohen dhe të merren parasysh ato propozime që ka bërë opozita. Nuk është bordi zgjidhja, por janë politikat qeveritare zgjidhja e këtij problemi.

Për t'iu referuar aktit në fjalë, unë kam dy pyetje.

Meqenëse bëhet fjalë për grosistët, për ata që duhet të mbajnë një rezervë tremujore, dhe rezervën tremujore, zonja Ministre, nuk mund ta mbajë çdo tregtar i vogël apo i mesëm shqiptar, a keni një listë të subjekteve që kanë detyrimin për të mbajtur rezervën tremujore dhe pastaj kanë edhe të drejtën për të aplikuar pranë bankave të nivelit të dytë për të shfrytëzuar këtë mundësi që u jep akti normativ dhe sa është numri i këtyre subjekteve?

E dyta, zonja Ministre, hipotetikisht, kur tregjet ndërkombëtare do të kthehen në një situatë normale, tregtia do të kthehet në një situatë normale, për të cilën të gjithë ne këtu shpresojmë të ndodhë sa më shpejt edhe për konsumatorin shqiptar, si do të rregullohet pjesa e stokut tremujor? Nëse nuk gaboj, është parashikuar tek rezervat e shtetit, por do të doja një detajim të kësaj problematike.

E treta, kam një sugjerim për të ardhmen. Para se të nxirrni vendime të Këshillit të Ministrave, siç bëtë para disa ditëve, që bazohen pikërisht në kredinë prej 30 milionë euro, kaloni aktin normativ njëherë dhe pastaj bëni edhe vendimin e Këshillit të Ministrave. Hierarkia është që kalon më parë ligji dhe pastaj kalon vendimi i Këshillit të Ministrave, kurse ju keni kaluar vendimin e Këshillit të Ministrave para disa ditësh dhe sot vini për të kaluar aktin normativ.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi - Faleminderit, zoti Bushati!

Fjala për ju, zonja Ministre.

Delina Ibrahimaj – Unë do t'iu rikthehem elementeve që lidhen me vendimin për të hyrë në këtë situatë dhe për të krijuar bordin.

Ndryshe nga vendet e tjera, unë e kam shpjeguar edhe herë të tjera, ulja e TVSH-së në Shqipëri është një politikë fiskale që nuk ka dhënë efektin e duhur në asnjë rast. Këto janë

elemente që janë studiuar me kujdes nga Ministria e Financave dhe kjo është arsyeja pse ne nuk besojmë tek ulja e çmimit nëpërmjet reduktimit të TVSH-së apo nëpërmjet përjashtimit të taksave dhe tatimeve.

Ne mendojmë dhe këtë mendim e kemi edhe të mbështetur nga të gjitha institucionet ndërkombëtare, që aty ku ka nevojë për mbështetje duhet ndërhyrë me subvencion apo me mbështetje për ato kategori, të cilat nuk arrijnë të përballojnë rritjen e çmimeve në rastin konkret.

Nëse bëhet fjalë për mbështetje të një sektori të caktuar të biznesit, duhet ndërhyrë me subvencion dhe jo me përjashtime fiskale. Në të gjitha rastet në Shqipëri, përjashtimet fiskale kanë treguar rritjen e inefficiencës, rritjen e informalitetit dhe rritjen e evazionit. Kjo është edhe arsyeja pse ne vendosëm të ndërhyjmë me mbështetjen e shtresave në nevojë, duke suportuar ato kategori që realisht nuk e përballojnë dot rritjen e çmimeve me një financim mujor për 3 muaj.

Për sa i përket kontrabandës, në fakt, unë i kam ndjekur vetë të gjitha mbledhjet e bordeve, duke qenë se ministri i Financave dhe Ekonomisë është kryetar i bordit të ushqimeve, dhe në asnjë rast nuk është ngritur kjo problematikë në mbledhjet e bordit. Nuk ka diferenca të theksuara të çmimeve të vajit në Shqipëri në krahasim me vendet e rajonit, pasi ne i kemi monitoruar gjatë gjithë kohës.

Për sa i përket vendimit për të hyrë në bord, ne e kemi thënë dhe do të vazhdojmë ta themi, nuk është qëllim yni ndërhyrja në treg duke krijuar të tilla borde dhe duke krijuar presion mbi tregun për të vendosur çmimet. Ne morëm këtë vendim, nga i cili urojmë të dalim sa më herët, për të hyrë në bord, qoftë për disa produkte bazë ushqimore, qoftë për karburantet, me qëllim që të siguronim transparencën në vendosjen e çmimit dhe të siguronim që çmimet nuk do të ndikoheshin nga spekulime, nga pritshmëri për rritje të mëtejshme të çmimeve, të cilat do të ndikonin në rritje.

Duke qenë se tregtarët presin që çmimet në faturat pasardhëse të rriten, atëherë ngrenë çmimin sot, duke mos reflektuar kostot e sotme, por duke reflektuar çmimin që do të jetë në të ardhmen. Kjo është arsyeja pse ne vendosëm të krijojmë bordet, me qëllim që të ndalojmë sa më pak pritjet inflacioniste për rritjen e çmimeve të produkteve bazë.

Sigurisht që nuk është as në synimet e politikave tona, as në mendimin që ne kemi se si duhet të zhvillohet tregu, pasi nuk është qeveria ajo që duhet të ndërhyjë, por janë kërkesat dhe oferta që duhet të ndikojnë në çmim dhe të përcaktojnë çmimin. Për këtë jemi të gjithë dakord besoj, por është situata e tillë që na detyroi të merrnim këtë vendim.

Për sa i përket pyetjes “Kush do të përfitojë nga ky akt normativ”, ne nuk kemi bërë një përcaktim. Pra, jo tregtarët me pakicë, por të gjithë importuesit, grosistët dhe përpunuesit e produkteve bazë mund të aplikojnë për të financuar blerjet e tyre të ardhshme nëpërmjet kësaj garancie sovrane.

Për sa i përket vendimit të Këshillit të Ministrave që u miratua javën e kaluar, akti normativ hyn në fuqi menjëherë pas miratimit. Nisur nga urgjenca që të gjitha sipërmarrjet kishin për të pasur akses në financa me norma interesi më të reduktuara, me kolateral të garantuar nga qeveria, ne vendosëm të shkonim me akt normativ dhe jo me një propozim ligjor, duke qenë që edhe i pari kishte qenë akt normativ. Nga momenti që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave ai ka fuqi ligjore. Për këtë arsye ne kemi proceduar me aktet nënligjore, me qëllim që të evitojmë të gjitha vonesat dhe të jemi në krah të biznesit sa më shpejt të jetë e mundur.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi - Faleminderit, zonja Ministre!

Ka edhe diçka tjetër për të sqaruar zoti Bushati.

Helidon Bushati – Zonja Ministre, kam edhe një pyetje për sqarim dhe transparencë, sepse lidhet shumë me këtë.

Është parashikuar detyrimi që importuesit të kenë një rezervë tremujore. Nuk besoj se çdo importues që kalon mall në doganë duhet të ketë një detyrim tremujor, se kjo do të ishte me të vërtetë e jashtëzakonshme.

Unë nuk e di sa është numri i importuesve në Shqipëri, por mendoj se duhet të jenë një grup i caktuar importuesish, sepse nëse do të jenë mijëra veta importues, atëherë edhe logjistikisht është pak e vështirë. Ndaj, kërkova të di dhe po e ribëj pyetjen ndoshta më të detajuar. Importues është edhe një person që importon një produkt të caktuar dhe jo domosdoshmërisht e mbulon të gjithë tregun shqiptar. Kush e ka këtë detyrim tremujor? Sa është numri i këtyre subjekteve? Nëse një prej importuesve të mëdhenj nuk do që të ketë rezervën tremujore, çfarë ndodh? Ata që aplikojnë te ky grup a duhet të kenë të bërë ...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këta që aplikojnë për linjën e kredisë pranë bankave të nivelit të dytë, a duhet ta kenë krijuar tashmë stokun tremujor apo do të pritët të lëvrohet kredia që të bëhet stoku? Këto janë elemente teknike, por shumë të rëndësishme për të ulur abuzimin, zonja Ministre, ndaj do të doja një sqarim në këtë kontekst.

Arben Pëllumbi - Fjala për ju, zonja Ministre!

Delina Ibrahimaj – Kjo garanci sovrane në radhë të parë jepet si ndihmë shtetërore për një sektor të caktuar. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë me abuzime. Është kredi dhe subjektet do të paguajnë norma interesi si çdo kredi tjetër, thjesht do të jepet me kushte më të lehtësuara, duke qenë se një pjesë e kolateralit mbulohet nga qeveria.

Për sa u takon numrave, subjektet kryesore që importojnë vaj luledielli, oriz, grurë dhe sheqer janë të kufizuara në numër. Pra, nuk bëhet fjalë për qindra dhe mijëra.

Ne i kemi listat. Për importimin e vajit janë 18, për orizin janë 7, për grurin janë 10-11. Pra, janë numra të kufizuar subjektësh. Megjithatë, edhe brenda këtyre numrave rreth 80% e produktit importohet nga 2 ose 3 furnizues. Pra, nuk bëhet fjalë për mijëra apo për një numër të pakontrolluar subjektësh. Gjithsecili prej tyre ka detyrimin të mbajë një rezervë 3 – mujore dhe 3 muaj llogariten nga blerjet që ata kanë kryer gjatë vitit të kaluar, nga sasia e blerjeve që kanë kryer gjatë vitit të kaluar.

Dua të theksoj se kur ngritëm bordet, ato nuk kishin dhe nuk kanë qëllim vetëm përcaktimin e çmimeve, por kanë qëllim edhe kuptueshmërinë e tregut, pasi është një treg që kontrollohet nga subjektet, jo nga shtetit. Për të gjitha kategoritë e subjekteve, pra për të gjitha produktet, tregtarët thanë se kishin rezerva të mjaftueshme edhe në momentin kur ne krijuam bordin. Kështu që, ata e kuptuan se duhet të garantonin që këto rezerva 3 – mujore të vazhdonin të mbaheshin. Kjo është edhe arsyeja pse ne po i suportojmë me garanci sovrane, me qëllim që ata të realizojnë detyrimin për t'i mbajtur këto rezerva. Në momentin kur ne do të dalim nga kjo situatë, nëse importuesit nuk do të arrijnë të shesin produktin e blerë, të cilin e kanë magazinuar për këtë afatin 3-mujor, atëherë, në aktin normativ, ne kemi përcaktuar që ky produkt do të blihet nga rezervat e shtetit.

Megjithatë, duke qenë produkte për të cilat ka një kërkesë dhe një konsum të lartë, aktualisht ka mungesë të tyre në tregjet ndërkombëtare, madje disa vende kanë kufizuar shitjen për konsum të përgjithshëm të këtyre produkteve, sidomos të vajit të lulediellit. Kur i referohem atij produkti, nuk mendoj se ai do të mbetet pa shitur. Në rast se mbetet pa shitur, qeveria merr përsipër ta blejë mbrapsht me kostot që e ka blerë importuesi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Ky akt normativ me të drejtë plotëson edhe aktin e nxjerrë të datës 18.03.2022 të Këshillit të Ministrave për transparencë dhe për monitorimin e çmimeve për artikujt e shportës. Sigurisht, mbajtja e rezervës 3-mujore nga ana e subjekteve që tregtojnë produkte, është mënyra analoge si me karburantet dhe lëndët djegëse, pasi është një domosdoshmëri për këtë periudhë, pse jo edhe më gjatë, që lidhet edhe me rezervat e shtetit...

(Deputeti Helidon Bushati ndërhyt pa mikrofon.)

Jo, të lutem.

Helidon, të lutem mos ndërhy, se po bëj unë pyetje.

(Deputeti Helidon Bushati vazhdon të flasë pa mikrofon.)

Helidon, unë nuk të kam ndërhyrë në pyetjet e tua.

Të lutem, mos ndërhy te pyetjet e mia. Bëji më pas pyetjet e tua.

(Debat në sallë pa mikrofon.)

Më lër të mbaroj.

Unë thashë ajo praktikë...

(Deputeti Helidon Bushati ndërhyt pa mikrofon.)

Të lutem, Helidon!

Kryetar do të vendosësh qetësi, se edhe unë do të prish pyetje pastaj.

Ju lutem!

(Deputeti Helidon Bushati ndërhyt pa mikrofon.)

Të lutem, mos e keqpërdor atë që thashë është një praktikë...

(Deputeti Helidon Bushati ndërhyt pa mikrofon.)

Të lutem, zonja Ministre, për ju dhe për stafin kam dy pyetje.

Dhënia e garancisë shtetërore me të drejtë, në adresë të këtyre subjekteve që tregojnë kryesisht produktet e shportës, a është e nevojshme që të kushtëzohet më tej me kriteret apo me kushtet, që subjektet t'i drejtohen edhe tregut vendas për prodhimet stok, që janë pjesë e shportës? Se ne flasim për vajin e lulediellit, por në rastin konkret, po vaji i ullirit? Po të bëhet një inventarizim në zonat që kultivojnë këtë kulturë, këtë bimë industriale, gjen rezerva vaji qysh parvjet. Kështu, edhe mundin e atyre njerëzve e kthejmë në vlerë, por edhe furnizohemi nga tregu i brendshëm. T'i themi tregtarit: po, do ta marrësh këtë garanci, do ta sigurosh këtë rezervë, por do t'u drejtohesh edhe prodhuesve të vendit.

Gjithashtu, edhe për grurin. Do të thoni ju që ne s'ia arrijmë dot me grurë, por duhet t'i drejtohem edhe tregut të brendshëm, në mënyrë që kjo gjë t'u vijë në ndihmë fermerëve të vendit tonë.

Si mendoni: është e nevojshme të ndërhyjmë në ligjet përkatëse, sidomos në ligjin për ushqimin, ashtu sikurse edhe në ligjet për lejet e tregtimit të hidrokarbureve, ku është një nen i veçantë për rezervat e sigurisë, apo vetëm kur na ndodhin raste të tilla të mendojmë për rezervat e sigurisë? Duhet të ndërhyjmë te ligji për ushqimin apo te ligji për rezervat e shtetit? Mbase na duket sikur nuk na duhen rezervat, se kemi tregun të hapur e të tjera, apo që do të

na vijnë mallra nga çdo pikë e globit, por ja që u dashkan rezervat. Rënia në pandemi na dha një mësim të madh neve edhe të gjithë botës.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Zonja Ministre.

Delina Ibrahimaj - Sa i takon pyetjes së parë, që duhet t'i drejtohem tregut vendas, çdo tregtar nëpërmjet kësaj garancie sovrane ka të drejtën të kërkojë kredi për furnizim. Pra, nuk është e kushtëzuar ndërmjet tregut vendas dhe tregut të huaj. Nëse tregu vendas do të ketë çmime më preferenciale dhe mbi të gjitha do të ketë ofertë për produktet që janë në treg dhe jo për produkte zëvendësuese, pra produktet që janë të përcaktuara në bord, vaji i lulediellit, sheqeri, orizi dhe mielli apo gruri, atëherë po, por ne nuk mund ta kushtëzojmë tregtarin të blejë në tregun vendas. Kjo ndodh, sepse nuk kemi asnjë instrument që ne të dimë sesa është prodhimi dhe kush e tregon grurit apo edhe të mund ta ndjekim atë. Nuk mund të shkruajmë në ligj diçka që nuk mund ta monitorojmë më pas. Megjithatë, në këtë krizë globale, sigurisht që tregtarët do t'i drejtohen tregut vendas.

Për sa i përket zëvendësimit të vajit të lulediellit me vajin e ullirit, prapë ne nuk mund ta detyrojmë konsumatorin të drejtohet te vaji i ullirit, por është çmimi i vajit që do të ndikojnë në zgjedhjen e konsumatorit. Pra, nëse vaji i lulediellit do të vijojë të rritet siç ka vijuar të rritet dhe do t'i afrohet në çmim vajit të ullirit, patjetër që konsumatorit do të drejtohet vetë te vaji i ullirit. Pra, nuk mund të vëmë përcaktime me bord, që të ndikojmë sjelljen konsumatorë.

Për sa i përket tregtimit dhe rezervave. Në fakt, për hidrokarburet është e përcaktuar në ligj të veçantë, që të gjitha subjektet e hidrokarbureve kanë detyrimin për mbajtjen e rezervës. Pra, nuk është çështje bordi, por është e përcaktuar në ligj dhe monitorohet nga Ministria e Infrastrukturës.

(Deputeti Helidon Bushtati flet pa mikrofon.)

Jo, linja e kredisë nuk është për...

(Deputeti Helidon Bushtati flet pa mikrofon.)

Deputeti iu referua detyrimit për mbajtjen e rezervave

Arben Pëllumbi – Zoti Bushati, ju lutem, mos ndërhyini pa radhë. Kur të mbarojë ministrja, merreni përsëri fjalën dhe flisni.

(Deputeti Helidon Bushtati vazhdon të flasë pa mikrofon.)

Zoti Bushati, ju lutem!

(Deputeti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon.)

Ismet, të lutem, mos bëj të njëjtin gabim që bën Helidoni dhe opozita.

(Debat pa mikrofon në sallë.)

Këta duan të na e prishin aktin normativ.

Lëre ministren të mbarojë përgjigjen. E kupton që ka ndërruar strategji opozita, kështu që mos i jep edhe ti ushqim më shumë.

(Deputeti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon.)

Po nuk mund t'ia ndërpresim fjalën ministres. Lëreni të mbarojë dhe pastaj flisni përsëri ju, se nuk ua mohon njeri të drejtën.

Delina Ibrahimaj – Për sa u përket hidrokarbureve, detyrimi për mbajtjen e rezervës është i përcaktuar me ligj dhe nuk është i përcaktuar me ligj detyrimi për mbajtjen e rezervës për produktet ushqimore, të cilat janë subjekte skadence, duan kushte të veçanta magazinimi dhe kanë nevojë për një kujdes të veçantë. Pra, nuk mund t'i trajtojmë njësoj.

Gjithashtu, edhe çështje sigurie kombëtare, hidrokarburet kanë një tjetër nivel trajtimi, ndërkohë ne po ndërhyjmë në bord dhe po vëmë detyrimin për këtë kategori produktesh, vetëm sepse Ukraina dhe Rusia, në rastin konkret, janë dy prodhuesit kryesorë të vajit të lulediellit dhe të grurit. Nëse do të ishte një konflikt në vende të tjera, të cilat nuk kanë ndikim në këto produkte, mbase do të ishte një masë tjetër për mbajtjen e rezervës për produkte të tjera. Urojmë që asnjë konflikt të mos ndodhë asnjëherë, por kjo është arsyeja pse ne po kërkojmë rezerva për këto produkte dhe jo për ndonjë arsye tjetër.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, zoti kryetar, nuk është korrekte, që këtu ballë për ballë dhe në prezencë të medias të devijohet fjala e një deputeti, qoftë i pozitës, qoftë i opozitës, sikurse bëri nënkryetari i këtij komisioni, zoti Helidon.

Ju lutem, se ju doni të bëni shou politik duke përdorur emrin e një deputeti, për një thënie të pathënë, zoti Helidon. Unë nuk kam fjetur mbrëmë as me ndonjë orakull, as shpreh mendime prej orakulli.

Ju lutem, duhet të jeni korrekt me integritetin e gjithsecilit prej nesh. S'ke pse e përdor një gjë të tillë. Nëse ti ke ndër mend ta thuash, thuaje, por tregu hidrokarbur ka vite që është i stabilizuar dhe punon me këto akte nënligjore. Më vjen keq që shkëlmi në një terren të cilin unë e njoh fort mirë, se kam eksperiencën e duhur dhe kulturën ligjore sesi është i rregulluar ky treg.

Ndërsa, kur fola për sigurinë e rezervave ushqimore, identike siç është për hidrokarburet, ajo është vendosur me aktin normativ nr. 7 të datës 18. 3. 2022. Shumë mirë që është bërë për 3 muaj, por fokusin dhe pyetjen më shumë e kisha te produkti stok i vendit. Në qoftë se ju doni të përdorni për shou politik fjalën, pyetjen apo diskutimin e një deputeti të maxhorancës, jeni drejtuar gabim dhe sidomos në adresën time.

Zoti kryetar, unë nuk e pranoj një klimë të tillë dhe një diversion të drejtpërdrejtë.

Arben Pëllumbi – Zoti Beqiraj, unë që drejtoj këtë komision e kam të pamundur të ndaloj secilin nga ju, që të shprehë atë mendim që dëshiron të shprehë. Ne prandaj jemi këtu përballë njëri-tjetrit, për të mbajtur qëndrime, për të treguar opinionet dhe për të bërë debate. Kështu që, në raste se mendoni, se dikush ju cenon, ju mund t’i përgjigjeni. Kështu funksionon.

Po, zoti Bushati, për të bërë një sqarim.

Helidon Bushati – Do të jetë ezaures sqarimi edhe shumë i shkurtër.

Zoti Ismet, në retorikën tuaj hyrëse, para pyetjeve për ministrinë, iu referuat këtij akti për të cilin po flasim dhe bëhet analogji edhe me tregun hidrokarbur. Kjo ishte. Nuk ishte në kuadër të rezervës. Ne nuk po flasim për rezervën, zoti Beqiraj. Rezerva është vendosur me aktin e mëparshëm. Ndryshimi i aktit të mëparshëm, e theksova edhe më përpara, ka lidhje me lëvrimin e garancive, me një garanci shtetërore, me një garanci sovrane që u jepet subjekteve, që me aktin e mëparshëm kanë detyrimin për të bërë rezervën 3 – mujore. Kur iu referuat rezervës hidrokarbure përmendët edhe fjalën “garanci”. Kupton? Duhet ta sqarojë këtë gjë, ose unë do të bëj transkriptin e procesverbalit të kësaj mbledhjeje dhe në seancën plenare të radhës do ta them prapë të njëjtën gjë. Që të mos lëmë vend për interpretime do të them: ja, një deputet i maxhorancës arriti të ishte aq largpamës, sa të detyronte qeverinë që të bënte një akt normativ të ngjashëm për një garanci për hidrokarburet, megjithëse ato e kanë detyrim që vite më përpara.

Kjo duhet të ishte një risi. Kaq. Ky ishte sqarimi ezaures.

Arben Pëllumbi – Mirë, shkojmë përtej kësaj dhe vazhdojmë me pyetjet.

Fjalën e ka zoti Mziu, pastaj zoti Duka.

Xhelal Mziu – Në fakt, ardhja e ministres sot më duket e rëndësishme, por për çështjen që po flasim, nuk lexoj ndonjë instrument, i cili do të ndikojë pozitivisht për zbutjen e krizës në të cilën ndodhet sot vendi dhe konsumatori, aq më tepër kur bëhet fjalë për produktet e shportës. Garancinë sovrane qeveria e ka aplikuar dhe e ka shitur si sukses, pavarësisht ka qenë me kosto zero, pothuajse. E ka shitur si sukses edhe në kohën e

pandemisë, madje një pjesë e atyre bizneseve nuk shkuan ta marrnin kredinë, sepse përqindja e interesit të vendosur ishte më e lartë sesa në tregun e lirë.

Nuk po merrem shumë me këtë pjesë, por ajo çfarë mua më shqetëson, është se ky instrument për të garantuar një rezervë 3 – mujore, ndërkohë edhe për t'i imponuar bizneset në një farë mënyre, për të marrë kredi, sepse ndoshta nuk kanë kapacitetet e nevojshme ekonomike për ta marrë atë, do të konvertohet në një çmim më të lartë për konsumatorin. Unë edhe si ekonomist, nuk shikoj asnjë lloj drite jeshile, që ky instrument do të ndikojë për uljen e çmimit, përkundrazi do ta rrisë çmimin. Unë them se mbështetja e qeverisë në mënyrë të drejtpërdrejtë sjell për pasojë rritjen e konsumit, duke u rritur konsumi, ulet çmimi, duke u ulur çmimi, ulet edhe varfëria. Këtë instrument di unë. Kurse instrumenti që përdorni ju, që në kulmin e krizës importuesit të krijojnë një rezervë për 3 muaj, jam absolutisht i bindur se do të rrisë kostot e mallrave.

Po ju sjell një shembull analog, shumica e investimeve sot nuk po zhvillohen, po flas për rrugët, sepse është rritur çmimi i produkteve, ndërkohë në aspektin e konsumit të produkteve të shportës, ne imponojmë importuesit të marrin kredi për të krijuar bazë.

Ju pak më parë thatë se eksperiencia e vendeve të tjera ka treguar se ndërhyrja në paketën fiskale nuk ka rezultuar pozitive. Në fakt, në Shqipëri nuk është përdorur asnjë lloj instrumenti. Vendet e tjera fqinje, po marr rastin e Maqedonisë dhe të vendeve të tjera, kanë aplikuar masa, madje duke e zeruar TVSH-në për produktet ushqimore dhe kjo masë ka dhënë efektivitet. Në Shqipëri nuk është aplikuar asnjëherë ndonjë masë e tillë, është aplikuar vetëm për naftën, por nafta në asnjë rast nuk i është dhënë atij që i takon, madje është dhënë në momente të tjera.

Bordet që janë krijuar nuk janë produktivë. Edhe bordi i karburantit nuk ishte produktiv dhe nuk është produktiv. Ne e kemi naftën sot gati 0,5 euro më të shtrenjtë sesa vendet e rajonit dhe e kemi 4 cent më shtrenjtë se Italia. Si ka mundësi që ne e kemi më të shtrenjtë naftën, ndërkohë po të shkosh në vendet e tjera e kanë më lirë se ne? E njëjta gjë ndodh edhe me produktet e shportës.

Unë sot me një grup do të shkojmë në Shkup dhe kam menduar ta mbush makinën me naftë sapo të kaloj në Strugë, sepse çmimi atje është 0,5 euro më lirë sesa këtu.

Meqenëse ju thatë se keni monitoruar edhe vendet e rajonit, unë do të sjell ditën e nesërme edhe çmimet në kohë reale se sa ishin çmimet e produkteve të shportës në Maqedoninë e Veriut dhe se sa janë këtu në Shqipëri.

Dua të them se ministrja e Financave, në fakt, duhet të ndërmarrë veprime të cilat konvertohen në mbështetje të drejtpërdrejtë ndaj konsumatorëve. Këto veprime që ju kryeni, nuk japin impakt të drejtpërdrejtë.

Banka Botërore sapo nxori një raport për menaxhimin e krizës së çmimeve për shkak të luftës në Ukrainë. Në lidhje me bujqësinë, për mbështetjen e drejtpërdrejtë ne ishim në vendin e fundit dje, por edhe në këtë raport të Bankës Botërore Shqipëria është në vendin e fundit: vetëm 0,3% e GDP-së, po themi, ose maksimumi 50 milionë euro kanë shkuar për menaxhimin e krizës.

Ndërkohë, po të shohim vetëm Maqedoninë, ajo e ka 3,3% të GDP-së ose të prodhimit të brendshëm bruto mbështetjen që do të jepet. Madje, 1,6% prej saj do t'u jepet në mënyrë të drejtpërdrejtë, po themi, konsumatorëve, për të mos u marrë pastaj me pjesën tjetër, që një pjesë e mirë e atij 5-milionëshit ka të bëjë me inflacionin e vitit të kaluar.

Ajo çfarë unë do të kërkoja, edhe një herë, është që duhet të përdorni instrumente të tjera: ulni TVSH-në për produktet e shportës dhe për karburantin ose hiqni taksën e qarkullimit, sepse këtë iniciativë që ju ndërmerrni, edhe për t'i zhytur në borxhe, sepse kjo qeveri thotë vetëm: “kredi”, “borxh”, “kredi”, “borxh”, tani po e instaloni edhe te bizneset, ajo do të konvertohet në çmime më të larta, në rritjen e shtresave të varfra dhe në një konsum më të vogël, po themi, në Shqipëri.

Një tjetër instrument. Jo vetëm në kohën e pandemisë, sipas Bankës Botërore, Shqipëria maksimumi 1% të GDP-së e konsumoi, por mesatarja e vendeve të Bashkimit Europian është 6,2%, ndërkohë vendet në zhvillim e kanë 3,1%, ndërsa ne me 1%. Pra, ju, duke qenë aktori kryesor i përdorimit të buxhetit të shtetit, duhet të ndërhyni në terma të cilët ose ulin taksat dhe tatimet, ose jepni mbështetje të drejtpërdrejtë. Ky është çelësi i kalimit të krizës, pasi efektet negative që la pandemia dhe efektet negative që do të lërë kjo do të konvertohen edhe më keq në periudhën në vazhdim edhe me rritjen e çmimeve, edhe me eksodin, edhe me çmime më të larta.

Po të shohësh edhe ato bordet e naftës, vendosin si në kohën e Enverit: “kaq do të jetë çmimi”. Po të shkosh nëpër karburante, do të vësh re se disa e kanë 249 lekë, disa e kanë 236 lekë, madje disa e kanë me çmim më të ulët sesa... Ju përcaktoni edhe çmimin e shumicës, gjë e cila më duket një absurditet. Që aty duket se është false, madje vendoset çmimi, po themi, me urdhër nga lart, pa bërë çmimin referent të zhdoganimit të naftës në doganë dhe duke aplikuar, po themi, me 3% apo 7%, qoftë edhe me 1% fitimin mbi produktin që ato shesin.

Këto ishin disa nga gjërat që desha t'ju sjell në vëmendje, zgjidhjet e mundshme dhe problemet, në referencë edhe me vendet e tjera të rajonit.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Mziu!

Nuk na zhgënjyet as sot, 20 minuta fiks e patët fjalën!

Fjalën e ka zonja ministre për përgjigjet e pyetjeve tuaja.

Delina Ibrahimaj – Atëherë, do ta filloj me garancitë sovrane dhe me ndikimin që ato kanë pasur qoftë në të kaluarën dhe pse është menduar të ecim me garancitë sovrane.

Lidhur me garancinë sovrane nr. 1, në radhë të parë, është e pavërtetë që normat e interesit kanë qenë më të larta sesa të tregut, pasi normat e interesit janë mbuluar nga qeveria, kanë përfituar 1100 biznese (pa interes) dhe kredia është shlyer pa problematika.

Pra, të bëjmë kujdes kur u referohemi fakteve, pasi ne i zgjedhim instrumentet në bazë të performancës. Kurrsesi nuk do të zgjidhnim një instrument për t'i ardhur në ndihmë biznesit, i cili nuk do të ndihmonte biznesin.

Garancia sovrane nr.2 ka qenë më vonë, pra ka qenë për t'i ardhur në ndihmë recuperimit të ekonomisë, rimëkëmbjes ekonomike; nuk ka qenë në kushtet për të mbajtur biznesin “gjallë”, në thonjëza; është dhënë me një normë interesi preferenciale, mesatarisht 5%; ka pasur rreth 492 miratime dhe ka qenë 60% e garantuar nga shteti.

Në të dyja rastet, *default*-i ka qenë shumë i ulët dhe interesi i bizneseve ka qenë i lartë.

Lidhur me kredinë sovrane, të cilën po e miratojmë sot, ju thoni se do të ketë një ndikim në rritjen e çmimeve. Në fakt, prej shumë vitesh tashmë, bizneset operojnë me *overdraft*-e dhe me kredi, dhe nuk angazhojnë kapitale për të blerë lëndën e parë apo për furnizim. Është praktikë e tyre dhe kostot e bankës janë kosto brenda kostove operacionale të çdo biznesi.

Duke dhënë një kredi të garantuar nga shteti, ne po garantojmë një normë interesi më të ulët dhe një garanci më të madhe për shpejtësi në dhënien e kredimarrjes. Por kjo nuk do të ndikojë kurrsesi në rritjen e mëtejshme të çmimeve.

Ju bëtë një skemë të ndikimit të çmimeve, pra të politikave në çmim, ku gjykoni se inflacioni varet nga këto përcaktime që ne bëjmë dhe se ajo që po bëjmë ne do të ndikojë edhe më shumë në rritjen e çmimeve.

Sollët shembullin e Maqedonisë së Veriut.

Maqedonia, për dijeninë tuaj dhe të publikut, funksionimin me borde e ka në ligj. Pra, ka strukturë të veçantë dhe bordet i ka pjesë integrale të politikave të saj. Ne kemi ngritur një strukturë *ad-hoc*, pasi mendojmë dhe besojmë tek ekonomia e tregut, ndërkohë që ata kanë një tjetër formë funksionimi të ekonomisë dhe të përcaktimit të çmimeve, pra kanë një

strukturë, e cila merret në mënyrë konstante, dhe jo sepse është krizë, por merret në mënyrë konstante me përcaktimin e çmimeve.

Përjashtimi i TVSH-së në Maqedoninë e Veriut ka qenë një politikë e cila ka pasur funksionin e saj, eficiencën dhe rezultatin e saj, duke kontrolluar çmimin. Pse? Sepse ka një strukturë tjetër biznesi, ka një strukturë tjetër taksimi. Këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se unë ju dëgjova me shumë vëmendje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...por janë analiza...

Ju lutem! Ju dëgjova me shumë vëmendje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një strukturë tjetër taksash, ndryshe nga ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kanë dhe mbledhin më shumë taksa sesa ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

95% e bizneseve, që tregtojnë produktet bazë (miell, vaj, sheqer dhe oriz), janë biznes i vogël dhe nuk e paguajnë TVSH-në, pra janë të përjashtuar nga TVSH-ja. Pra, edhe ne po ta heqim TVSH-në, ato përsëri nuk e paguajnë këtë TVSH.

Dua të them se, duke pasur struktura të ndryshme, ju nuk mund të krahasoni dy vende me politika të ndryshme.

A ka vend për përmirësim në politikat që bëjmë? A ka vend për të bërë nxitje më të madhe për të pasur një efekt në çmime? Hajdeni të ulemi ta diskutojmë. Por, kur marrim raste dhe shembuj, duhet ta bëjmë analizën siç duhet.

Ato vërtet kanë kosto më të ulët për tregtimin e produkteve bazë të shportës, por kanë kosto më të lartë për punën, kanë kosto më të lartë për sigurimet shoqërore, kanë të tjera elemente që çojnë në rritjen e çmimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të bëhet një analizë me një element të caktuar, pasi secili ka sistemin e vet fiskal dhe tatimor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i takon rritjes së çmimeve, janë çmime që vijnë totalisht...

(Deputeti Mziu flet vazhdimisht pa mikrofon.)

Ju lutem! Unë ju dëgjova me shumë vëmendje. Ne nuk po bëjmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju dëgjova me shumë vëmendje për 20 minuta. Tani, duhet të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk them asnjë gënjeshtër. Nuk jam këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Zoti Mziu, a ka mundësi, ju lutem? Kur të mbarojë ministrja, do të flisni ju.

Delina Ibrahimaj – Unë vij këtu me përgjegjësi të plotë dhe nuk them asnjë gënjeshtër. Nuk jam këtu për të gënjyer askënd, por jam këtu për të sqaruar.

Arben Pëllumbi – Zoti Mziu, ju folët 20 minuta dhe nuk ju ndërpreu askush, edhe pse në shumicën e asaj që thoni ne mund të mos jemi dakord.

Tani, lejojeni ministren të japë shpjegimet e saj. Nëse ka diçka për të cilën ju përsëri nuk jeni dakord, këtu jemi, mund të vazhdojmë të flasim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Delina Ibrahimaj – Ju thatë se “Ne po shtrenjojmë koston, se politika jonë është: kredi, borxh, kredi, borxh”. Borxhi ka ardhur në reduktim, borxhi ka sjellë rritje ekonomike, gjë të cilën unë e kam shpjeguar disa herë dhe nuk do të lodhem së shpjeguari.

Borxhi është rritur, siç është rritur në çdo vend të botës në vitin 2020, dhe në vitin 2021 borxhi erdhi në reduktim. Pse erdhi në reduktim? Sepse u përdor në ata sektorë që sjellin rritje ekonomike dhe u përdor me eficiencë.

Të gjitha politikat që kemi ndërmarrë janë mbështetur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Në asnjë libër ekonomie nuk sugjerohet që në raste krizash të lëvizin politikat fiskale. Çfarëdolloj sugjerimi vjen në mbështetje të shtresave në nevojë, vjen në mbështetje të atyre që nuk e përballojnë dot çmimin.

Nëse ne do të lëvizim me politikat fiskale, do të krijojmë disbalanca dhe paqartësi, si dhe do të ndikonim edhe më keq në të gjithë ciklin e pasigurisë dhe në rritjen e çmimeve.

Unë mendoj që si politika fiskale, ashtu edhe ajo monetare, kanë pasur drejtimin e duhur dhe janë ndërmarrë nismat e duhura, me qëllim limitimin e rritjes së çmimeve.

Është fakt që inflacioni në Shqipëri, qoftë ai i përgjithshëm, qoftë ai i ushqimeve është më i ulët sesa i vendeve të rajonit, është më i ulët sesa i vendeve të Europës. Ne sot kemi një inflacion 6,2%, ndërkohë që nëpër vendet e rajonit ka gjithmonë norma më të larta.

Për sa i përket mbështetjes dhe artikullit të cilit ju iu referuat, unë dua t’ju bëj me dije se Shqipëria ka pasur një mbështetje më të lartë sesa Bosnjë-Hercegovina dhe më të lartë sesa Mali i Zi. Nuk mund të merren si shembuj vetëm Maqedonia e Veriut dhe Bosnja...

Pra, “vendet e rajonit” nuk janë vetëm Maqedonia dhe Serbia, por janë të gjitha vendet e rajonit. Kështu që, le t’i shohim më në total politikat dhe t’i gjykojmë në të gjitha komponentët e tyre.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja Ministre, për shpjegimet që dhatë!

Në fakt, unë kam bërë një marrëveshje sot me Komisionin për Ekonominë dhe Financat për t’ju pasur në dëgjese një orë, sepse në orën 11 fillojnë ata.

Kështu që, me lejen edhe të kolegëve, ju mund të vazhdoni, ndërkohë disa nga kolegët tuaj mund të qëndrojnë për të vazhduar te ne...

(Deputeti Mziu dhe ministrja Ibrahimaj flasin pa mikrofon.)

Po, zoti Duka.

(Diskutime në sallë)

Agron Duka – Faleminderit!

Unë e mirëkuptoj që situata e krizës, përveç të tjerave, shkaktuar edhe nga Ukraina, e fut në diskutim problemin e çmimeve dhe të sigurimit të mallrave të shportës në Shqipëri. Ka mënyra të ndryshme. Gjithsesi, unë jam kundër kësaj që rekomandohet. Po jua argumentoj pse. Nuk besoj se është normale që shteti të japë garanci sovraane për disa lloj mallrash të shportës, siç janë, ku di unë, sheqeri, gruri e të tjera, i ka të përcaktuara aty, dhe t’i thotë: do të marrë rezerva për tre muaj, të fusë veten në një siklet të madh që pas 3 muajsh, pavarësisht se thotë ministrja që, dëgjo, nuk ndodh që nuk shiten, kësaj nëse nuk ka... Por ndodh që shiten. Atëherë, shteti i futet prapë llogarisë, i merrka atij atë mallin, me çfarë çmimi ia merr, nuk e di, si e llogarit?

Ndërkohë, unë gjykoj se ka një ligj për rezervat e shtetit, madje besoj se ka edhe fond për atë punë. Ndoshta këta zotërinjtë mund të na e thonë.

Rezervat e shtetit duhet të kenë, domethënë, brenda magazinave të tyre, një sasi të konsiderueshme malli me rezerva tremujore, sidomos për mallrat e shportës. E përse qenka e nevojshme që këtë ta bëjnë nëpërmjet privatit, nëpërmjet një garancie sovraane? Nuk mendoj se është normale.

Kështu që për këtë pjesë kisha vetëm një pyetje: a ekziston një ligj për rezervat e shtetit? Nëse po, si e parashikon ai këtë punë?

Çështja tjetër, vendosja e këtyre çmimeve me borde, as për këtë nuk jam.

Nuk mendoj se, domethënë, nëpërmjet bordeve të mund të vendosim çmime në një sistem të tillë, pavarësisht se jemi në periudhë krize.

Të jeni të sigurt ju dhe ata që merren me biznes, se këtë punë e rregullon më së miri konkurrenca e tregut. Me magji... Nuk ka nevojë fare. Hiç! Unë nuk besoj kurrë se të mund të ketë borde që do ta rregullojnë këtë me makinacione. E cila është metoda, xhanëm?

Supozojmë që dikush shtet grurë. Mirëpo, nuk është vetëm një, janë nja 10 në Shqipëri, të mëdhenj po themi, dhe disa të tjerë. Ata do të konkurrojnë njëri-tjetrin me 1-lekësha, me 2-lekësha, unë e di mirë këtë punë, bie fjala, vezë me 1-lekësha, 2-lekësha. E çfarë bën bordi këtu? Pastaj, cilat janë mënyrat, dua të di tani? Cilat janë mënyrat e vendosjes së çmimit, domethënë, ndërmjet këtyre bordeve? Si përcaktohen ato? Sepse, me sa di unë, një njeri që merret me biznes thotë: ka një kosto prodhimi ose një kosto blerjeje, ka një kosto amortizimi, ka një kosto administrative, ka taksa dhe tatime, pastaj ka një normë fitimi.

Ju çfarë bëni? Ndonjë magji tjetër? Nuk e di, si e vendosni çmimin?

Këto dy pyetja kisha.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duka!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Saimir Muçmataj – Përshëndetje, i nderuar zoti kryetar i komisionit!

Atëherë, akti normativ, si akti normativ nr. 7, qoftë ndryshimi i këtij që po bëjmë nëpërmjet këtij akti, në vetvete është një mekanizëm ligjor. Në rastin që e parashikon një situatë më të veçantë sesa kjo që kemi, bëjmë një lloj pezullimi të çmimit. Pra, sikur nesër çmimet të rriten dyfishi apo diçka më shumë se kaq, duke pasur një rezervë, biznesi mund ta pezullojë këtë çmim në rast se do të ketë blerë më shumë mall më parë. Domethënë, kjo është pjesa e rezervës.

Në lidhje me pyetjen për rezervat e shtetit, po, ka një ligj për rezervat e shtetit; është në fushën e përgjegjësisë së ministrit të Brendshëm.

Ndërsa në lidhje me çmimin, se si do t'i blejë Rezerva e Shtetit, me çfarë çmimi do t'ua marrë bizneseve, kjo përcaktohet... i është lënë një autorizim Këshillit të Ministrave në aktin normativ nr. 7, që me një VKM të përcaktohet mënyra e përcaktimit të çmimit se sa do t'ua blejë bizneseve rezervat.

Në lidhje me...

Nikolla Lera – Lidhur me dy pyetjet e tjera të zotit Duka, pra nëse bordet janë legjitime dhe cila është mënyra e vendosjes së çmimeve, si merren...?

Agron Duka - Unë nuk vë në dyshim nëse janë ose jo legjitimë... Por gjykoj se nuk janë të nevojshëm.

Nikolla Lera – Tani, bordet u krijuan me akt normativ, pra me ligj, dhe u gjykua që janë të nevojshme në kushtet kur bota po shkonte drejt një situatë të panjohur, kur indiciet

ishin që disa nga produktet kryesore, të cilat në pjesën dërrmuese furnizohen nga vendet në konflikt, do të kishin ndërprerje të furnizimit (gjë të cilën e kemi të verifikuar gjatë kësaj periudhe); në kushtet kur, për shkak të luftës, furnitorët do të importonin mallra me çmime shumë të ndryshme, me kosto shumë të ndryshme, me kontrata që ishin lidhur para se të fillonte lufta, me kontrata që u lidhën gjatë luftës apo që do të lidheshin më pas; në kushtet kur një furnizim me një kontratë të lidhur para 4 muajsh do të vinte në periudhën e luftës (pra, çmimi ishte i fiksuar i ulët, siç ka qenë para luftës, por çmimi i tregut këtu do të ishte rritur shumë më tepër)...

Atëherë, në kushtet kur mund të ndodhte një spekulim në treg dhe të kishte shumë gjasa që konsumatori të vuante çmime jo të ndershme tregu, pra çmime të pakontrolluara, çmime jo të ndershme tregu, u pa e arsyeshme që katër produktet kryesore (pra, mielli, sheqeri, vaji dhe orizi), në morinë e mijëra produkteve ushqimore, të mund të kontrollohen nga ky bord.

Si bëhet kontrolli?

(Deputeti Duka flet pa mikrofon.)

Autoriteti i Konkurrencës fillon një studim sot dhe e mbaron pas gjashtë muajsh, ndërkohë që pas gjashtë muajsh lufta mund të ketë përfunduar.

Ne duhet ta mbrojmë konsumatorin shqiptar çdo ditë, jo...

(Deputeti Duka flet pa mikrofon.)

A e dini ju sa zgjat një investigim i Autoritetit të Konkurrencës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, po.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nikolla Lera – Në rregull.

Ne marrim në konsideratë çdo të dhënë që është e nevojshme për të përcaktuar çmimin e shitjes me pakicë për konsumatorin. Çfarë marrim parasysh?! Marrim parasysh çmimet, me të cilat importojnë produktet importuesit kryesorë; marrim parasysh çdo marzh bruto dhe çdo fitim neto të deklaruar nga ana e tyre në periudhat normale; marrim parasysh të gjitha shpenzimet operationale që i kanë të domosdoshme importuesi, tregtari me shumicë dhe tregtari me pakicë. Bazuar në koston e importit dhe në këto marzhe që ne shtojmë, të cilat, sikurse thashë, bazohen në marzhet që kanë deklaruar në periudhat e mëparshme, por edhe në marzhet që deklarojnë, sepse duhet ta dinë që në bord bëhet një luftë, sepse edhe kostot e operatorëve janë rritur. Pse janë rritur kosto ?! Sepse është rritur karburanti e të tjera...

(Diskutime pa mikrofon.)

Normë fitimi nuk caktojmë fare. Ne caktojmë vetëm marzh, me të cilin do të mbulojmë shpenzimet operationale, të cilat janë, pak a shumë, të njëjta me ato që kanë deklaruar në periudhat e mëparshme, ku pjesë mund të jetë edhe fitimi. Ne nuk merremi me fitimin tregtar. Ne merremi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Duka, edhe një herë, t'jua thjeshtoj: ju e dini shumë mirë që pasqyra e të ardhurave dhe të shpenzimeve ka koston e mallit të blerë, shpenzimet operative dhe të ardhurat. Shpenzimet operative që mbulojnë çdo shpenzim, që bën kompania përveç kostos së mallit të blerë, pasqyrohen në këto marzhe që ne caktojmë. Pra, është shumë e thjeshtë, janë shumë pjesëtarë, gjithçka është transparente, gjithçka është sipas dokumenteve, gjithçka është në bazë të evidencave dhe asgjë nuk mund të krijojë dyshime. Natyrisht, kjo nuk është një gjë që mund të vazhdojë, sepse edhe ne e kemi shumë të vështirë me ushqimet tani, e kemi më të lehtë me karburantet, sepse ka çmime burse dhe janë vetëm dy artikuj gazoili dhe benzina. Ndërkohë, sikurse thashë, në ushqime kemi një problematikë të madhe, sepse diferencat e çmimeve, me të cilët importohen, mallrat janë shumë të ndjeshme, sepse dikush e sjell vajin me 230 lekë dhe dikush me 380, por ju të jeni të sigurt që, nëse ne do ta linim pa bord, vaji do të shitej 380 dhe ai që e ka importuar me 220 do ta shiste me 380 lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne kemi fakte që këto kanë ndodhur dhe bordi...

Arben Pëllumbi – Zoti Lera, të falënderoj për përgjigjen, por ajo çfarë është esenciale për të sqaruar edhe në këtë akt normativ, është që qëllimi, për të cilin neve gjykojmë për të ngritur bordet, ishte ndalimi i spekulimit. Pra, në kohë lufte, në kohë të vështira, në momente të paqarta rezulton që individë të ndryshëm spekulojnë me çmimin. Ky është qëllimi që është ngritur bordi, që të jemi të qartë për ata që na ndjekin. Qeveria ndodhet para dy alternativave: ose do të bënte një ulje të taksave, duke përfshirë edhe TVSH-në, por nga eksperiencia që kemi pasur kur kemi bërë ndërhyrje të tilla, nuk na ka rezultuar në ulje të çmimit, por na ka rezultuar në fitime më të larta për kompanitë ose do të ndërhyjmë për të ndaluar spekulimet. Sigurisht, zgjedhëm këtë rrugën e dytë, duke ndërtuar këto lloje bordesh, sepse nuk besoj se është ndonjë kënaqësi e veçantë për ju që të mblidheni herë pas here që të debatoni e të diskutoni për një punë, që, në fakt, nuk është detyra juaj e përditshme normale dhe në kushte normale. Kështu që të gjykojmë se kjo është arsyeja pse bëmë këto akte normative dhe ndërtuam këto borde.

Së dyti, ashtu siç e tha me të drejtë zoti Beqiraj, në kushte të jashtëzakonshme, sikurse në kushte të zakonshme hidrokarburet e kanë për detyrë që të kenë një stok, sepse është elementi i sigurisë kombëtare. Në kushte të jashtëzakonshme, siç ndodhemi tani, duhet që edhe për këto 4 elementet e shportës të kemi një stok 3-mujor, sepse mund të ndodhë një e papritur që për një periudhë të caktuar të mos kemi furnizime me këto produkte dhe, sigurisht, popullatës nuk duhet t'i mungojnë këto elemente kryesore. Kjo është arsyeja që kërkohet një stokim 3-mujor për këto 3 elemente të shportës dhe, për sa kohë bizneset, të cilat merren me këto produkte mund të ndodhen në vështirësi financiare, shteti po i ndihmon duke u dhënë këtë garanci sovranë. Nuk ka asgjë më të ndryshme dhe më të jashtëzakonshme, ndodhemi në një situatë të jashtëzakonshme dhe marrim disa masa, të cilat i gjykojmë të nevojshme për situatën, në të cilën ndodhemi.

A ka dikush nga kolegët diçka tjetër për të shtuar?

Zoti Ndraxhi.

Ilir Ndraxhi – Faleminderit!

Ky akt normativ ka një rëndësi të veçantë për situatën që po kalojmë. Si pasojë e rritjes së çmimeve të energjisë, naftës, gazit dhe luftës në Ukrainë, janë prishur të gjitha linjat e furnizimit të gjitha produkteve si të shportës, edhe metalet e të gjitha të tjerave. Kështu që mbështetja, që kërkon biznesi për të pasur stokun prej 3 muajsh, është e pamundur ta përballojë vetë kundrejt rritjes që kanë pësuar çmimet herë me përbindje dhe herë me shumëfishim të ndryshimit të çmimeve. Kështu që unë e përkrah këtë lloj akti normativ dhe këtë nismë të qeverisë.

Kam një sugjerim. Tani jemi në fillim të korrjeve të grurit, pra sapo ka filluar korrja e grurit. Nga informacionet që kam, për momentin, falë edhe nismës “Ballkani i Hapur”, mbështetja nga Serbia ishte konkrete për situatën që u krijua nga prishja e linjës së furnizimit të grurit dhe të misrit. Sot gruri vjen nga Serbia afërsisht me 380 euro, pa TVSH-në, që është afërsisht 43-44 lekë pa TVSH. Sugjerimi është që prodhimi i vendit, në prag të korrjeve, përderisa ne i mbështesim me garanci sovranë prodhuesit e miellit dhe u japim mundësinë, pra ua heqim edhe frikën e stokut 3-mujor kundrejt ndryshimit të çmimit nesër, ne kemi një prodhim shumë të vogël të sasisë së grurit. Unë sugjeroj që të merret parasysh që qeveria të mos e kalojë te rezervat shtetit, por ta kalojë te magazinat e fabrikave nën përgjegjësinë e vet, të diktuar nga çmimi, që ta mbrojë prodhimin e vendit dhe atë çmim përderisa t'i ia jep çmimit të importit dhe e mbron nga humbja, të paktën mbro prodhimin e vendit, për aq kohë sa ka një sasi X dhe kjo grumbullohet dhe shoqërohet me dokumente, me NIPT-in që kanë fermerët dhe e çojnë në magazina që sugjerohen dhe kontrollohen nga shteti. Këtë kisha.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Zoti Duraj.

Laert Duraj – Megjithëse kolegët e opozitës nuk janë, përsëri në fjalën time, në njëfarë mënyre, do t'u referohem atyre.

Për sa i përket qasjes fiskale midis të majtëve dhe të djathtëve, është një jetë që ato janë të ndryshme. Kështu që nuk diskutohet që ne mendojmë se politika fiskale, që aplikojmë, është më e duhura për të konsoliduar dhe për të bërë një qeverisje më të mirë. Ndërsa, kur vjen puna tek instrumentet e jashtëzakonshme që përdor një qeveri e caktuar për të zgjidhur një situatë të jashtëzakonshme, siç është kjo në të cilën ne ndodhemi, jo vetëm unë, por të gjithë ne jemi besimplotë se qeveria jonë edhe në këtë rast ka gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme. Këtë e them nisur nga përvoja e këtyre viteve të fundit, përvojë jo e mirë, pasi Shqipëria është përballuar me dy kriza shumë të mëdha, të cilat, në gjykimin tim, janë menaxhuar mjaft mirë nga qeveria e Partisë Socialiste. Kështu që edhe në këtë rast besimi nuk do të lëkundet, pasi kjo përvojë do të shërbejë për të zgjidhur dhe për të gjetur rrugët më të mira të mundshme, por në këtë pikë edhe kolegët opozitës shprehën dakordësinë e tyre, pavarësisht qëndrimit që do të kenë me votë, në lidhje me këtë projektligj dhe me këtë akt. Edhe unë nuk kam mendim ndryshe për këtë gjë, e vlerësoj jashtëzakonisht pozitivisht këtë akt dhe njësoj, si disa prej kolegëve, mund të kem ndonjë pyetje teknike, e cila ka të bëjë me implementimin sa më efikas të këtij akti normativ.

Për shembull, flasim për një treg, por nuk kemi aq shumë në dorë për të vepruar. Çfarë do të ndodhë me grosistët e mëdhenj, të cilët do të marrin një kredi relativisht të madhe për një produkt të caktuar kur pas 2-3 muajsh kjo rezervë tregu do të përballlet me ndryshime pozitive, pra mund të ulen çmimet? Çfarë do të ndodhë në këtë rast? Është një lloj kosto e caktuar që duhet të kihet në konsideratë ose a mundet bordi dhe Ministria e Financave në këtë rast të vënë disa kushte në kontratën e kredisë, të cilat parashikojnë edhe këto situata që ndodhin në të ardhme?

Kam një tjetër pyetje teknike, sepse zonja ministre, kur foli për kredinë, tha se bankat kanë kosto të caktuara të kredidhënies, të cilat, në njëfarë mënyre, do të mbulohen, por këto kosto janë relative, janë të ndryshme, nga banka në bankë, mund të kenë politika të ndryshme tarifore e të tjera me radhë, pra a mundet që, siç është vepruar te rasti i çmimeve të shportës, këto kredi të mos detyrohen, por të vihet një lloj limiti? Pra, jo më shumë se kaq për qind. Sigurisht, dikush mund të thotë me 5%, se është konsumator, me 7% por edhe me 2% mund t'i përballonte kostot. Pra, a mund të vihet një tavan që këto kredi të kenë jo më shumë se kaq dhe bankat brenda këtij tavani të operonin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e di nëse jam i qartë te kjo pjesë, zonja Lili?

Siç vendosim një çmim tavan për vajin, që do të shesin këta grosistë me kredi, a mund të vendoset një tavan për koston e kredisë për këtë gjë?

Së fundi, në njëfarë mënyre të imponojë edhe kohën e livrimit të kredisë, sepse ka rëndësinë e saj. Pra, në qoftë se një grosist ka një kontratë të caktuar me një prodhues të grurit në Turqi, sigurisht që edhe koha ka vlerën e saj. Pra, ai ka bërë një *deal* të caktuar që livrimi dhe e gjithë procedura e nisjes dhe firmosjes së kontratës dhe e livrimit të fondeve, në njëfarë mënyre të ishte një lloj *fast line* që të jepte një dorë të caktuar në këtë treg, i cili është tepër dinamik.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duraj!

Po, urdhëroni!

Brikena Jazxhi – Për sa u përket termave të garancisë sovrane, mund t'ju informoj se garancia sovrane, sikurse e tha edhe zonja ministre, që mendohet për prodhuesit dhe importuesit e produkteve bazë, do të jetë 60% e garantuar nga shteti nëpërmjet linjave të kredisë në bankat e nivelit të dytë. Sikurse u përmend edhe pak më parë, garancia sovrane është miratuar me vendim të qeverisë javën e kaluar dhe, sigurisht, duke qenë një garanci shtetërore ka terma më lehtësues për bizneset. Është vendosur një normë interesi e bazuar në bonot 12-mujore të thesarit plus një marzh maksimal prej 3%. Pra, është vendosur një limit në normën e interesit që mund t'ju jepet kredia, edhe kjo është një favorizim.

Gjithashtu, afati i aplikimit është 2 muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes nga ministri i Financave me bankat e nivelit të dytë, por nuk është e thënë, mund të merret edhe para këtij afati. Kohëzgjatja e kredisë është 3 vjet, afati maksimal dhe në çdo rast banka do të lidhë edhe një marrëveshje huaje të veçantë me bizneset. Në përgjithësi këta janë termat e garancisë sovrane.

Për sa i përket sugjerimit që tha zoti deputet, pra për të marrë produktet ushqimore, në rast se nuk do të shiten, në aktin normativ është përcaktuar që do të riblihen nga rezervat e shtetit. Propozimi juaj do të mbahet në konsideratë nëse do të ketë ndryshime të këtij akti normativ.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

5 minuta pushim dhe më pas kalojmë në procesin e votimit.

(Pas pushimit)

Arben Pëllumbi – Rifillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Sikurse edhe diskutuam në pjesën e parë, kemi shqyrtimin dhe votimin e aktit-normativ nr. 9, datë 11.05.2022, “Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”. Ne jemi në procesin e votimit dhe kuorumin e kemi, kështu që e hedhim në votim.

Kush është dakord me aktin normativ? 11 vota pro. Kundër? Abstenim nuk ka.

Miratohet ky akt normativ dhe përgatitet për seancën plenare të ditës së enjte.

Faleminderit, kolegë!

Mbyllet mbledhja!

MBYLLET MBLEDHJA